



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE BUJQËSORE, PYJEVE, MJEDISIT DHE VETERINARISË

Nr. 2344 prot

Fier më 21 02 . 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 22 datë 21 / 02 /2025

PËR NJË SHITESË NË VKB-NË NR. 145 DATË 23.12.2024“ PËRMIRATIMIN E STUDIMIT TEKNIKO-EKONOMIK PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË FIER QË PREKET NGA NDËRTIMI I NËN STACIONIT TË HOXHARËS (NËN STACIONI DHE VENDOSJE SHTYLLE) DHE DHËNIA NË PËRDORIM PËR SHTRIMIN E LINJËS SË RE 220 KV DOPJO QARK FIER – HOXHARË ME PËRCJELLËS ACSR 490/65”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më datën _____.____. 2025 i paraqitet për shqyrtim materiali nga Drejtoria e Çështjeve Bujqësore, Pyjeve, Mjedisit dhe Veterinarisë “ Për një shtesë në VKB-në nr.145 datë 23.12.2024 “Për miratimin e studimit tekniko ekonomik për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Fier që preket nga ndërtimi i nënstacionit të Hoxharës (nënstacioni dhe vendosje shtylle) dhe dhënie në përdorim për shtrimin e linjës së re 220 KV dopjo Qark Fier – Hoxharë me përcjellës ACSR 490/65”

Në zbatim të :

1. Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet“ neni 5.
2. Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “ Për VetëQeverisjen Vendore “ indryshuar neni 27 pika 5.
3. VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 “ Për dhënie në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”.
4. Udhëzimin nr. 1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” pika 22 dhe 23 .
5. VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimit dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore” të ndryshuar, pika 13.3
6. Shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr.383/1 prot, datë 22.01.2025 “ Mbi VKB-në për ndërtimin e nënstacionit Hoxharë”, ekzekutivi

PROPOZON

1. Në pikën“ 1”të VKB-së nr.145 datë 23.12. 2024 të shtohet në fund të kësaj pike togëfjalshi “ ngastra6/b e ekonomisë pyjore “ Bregdet Seman Ndërnënas”dhe pika do të bëhet si vijon:

“ Miratimi i studimit tekniko ekonomik për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes prej 2.8369 ha që preket nga ndërtimi i nënstacionit dhe dhënia në përdorim për shtrirjen e linjës prej 0.137 km me afat kohorë sipas grafikut të punimit (14 muaj) , ngastra 6/b, ekonomia pyjore “ Bregdet Seman Ndërnënas”.

2. Për vazhdimin e mëtejshme të procedurave administrativo – ligjore me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe subjektin OST ngarkohen Drejtoria e Çështjeve Bujqësore, Pyjeve, Mjedist dhe Veterinarisë pranë Bashkisë Fier .

Drejtoria Çështjeve Bujqësore, Pyjeve, Mjedist dhe Veterinarisë

Konc: Ing. R.Sera

Miratoi : Drejtori i Çështjeve Bujqësore, Pyjeve, Mjedist dhe Veterinarisë
F. Avdiaj

Drejtoria Juridike
E. Kapllanaj

KRYETARI
Armando Subashi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETAR
Vasil Bregu

